



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**Kryesues i Këshillit Drejtues**  
Prof. dr. Ali Topalli

Nr. Prot. 1216 Dt 25.06.2021

Në bazë të nenit 21, pika 1, të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 25.6.2021, mori:

**VENDIM**

1. Aprovohet draft-Rregullorja mbi punën e Këshillit Drejtues të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
2. Pjesë e këtij vendimi është Rregullorja mbi punën e Këshillit Drejtues të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Zyrës për Informim me Publikun.

Kryesuesi Këshillit Drejtues  
Prof. dr. Ali Topalli





**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

**Kryesues i KD-së**  
Prof. dr. Ali Topalli

Nr. Prot. 1216 Dt 25.06.2021

Në bazë të nenit 21, pika 1, të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2021, miratoi:

**RREGULLOREN**  
**mbi punën e Këshillit Drejtues të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Këshillit Drejtues të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (thirrja e mbledhjes, mbajtja, mënyra e vendosjes dhe zbatimi i vendimeve, si dhe çështjet e tjera përkatëse).

**Thirrja e mbledhjes konstitutive**

**Neni 2**

Mbledhjen konstituive të Këshillit Drejtues e thërret anëtari më i vjetër nga përbërja e zgjedhur, i cili e kryeson atë vetëm derisa të zgjidhet kryesuesi i Këshillit Drejtues.

**Verifikimi i mandatave**

**Neni 3**

- 1) Në mbledhjen e parë, Këshilli Drejtues e verifikon mandatin e anëtarëve të Këshillit Drejtues në bazë të raportit të sekretarit të përgjithshëm, në lidhje me rregullsinë e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues nga Senati, si dhe të zgjedhjes së anëtarëve në Këshillin Drejtues nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- 2) Raporti votohet në dy pjesë, njëherë për anëtarët e zgjedhur nga Senati dhe njëherë për anëtarët e emëruar nga MASHTI.
- 3) Nëse Këshilli Drejtues konstaton se emërimet nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ose nëse ekziston ndonjë konflikt interesi për një apo më shumë anëtarë të Këshillit Drejtues, atëherë brenda një periudhe prej dy javësh kërkon nga institucioni përkatës sqarime dhe veprime konkrete ligjore lidhur me zgjedhjet e anëtarëve të brendshëm apo emërimet e anëtarëve të jashtëm të kontestuar.
- 4) Në rast të kontestimit të zgjedhjeve apo emërimeve, mbledhja konstituive e Këshillit Drejtues ndërpritet derisa zgjedhjet apo emërimet të jenë përsëritur në mënyrë të suksesshme.

**Nënshkrimi i deklaratës etike**

**Neni 4**

Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e pranishëm të Këshillit Drejtues e nënshkruajnë deklaratën etike me sa vijon: “*Deklaroj se do t’i kryej detyrat me nder dhe besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, se do të kontribuoj në përmbushjen e detyrave të Këshillit Drejtues, se do ta ushtrtoj mandatin tim*”



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

---

*me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t'i përfaqësoj me ndërgjegje dhe përkushtim interesat e Universitetit dhe se do t'i përmbahem Statutit të Universitetit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës".*

**Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit**

**Neni 5**

- 1) Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i Këshillit Drejtues zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues, nga radhët e anëtarëve të deleguar nga MASHT-i.
- 2) Të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues shërbejnë në cilësi individuale në Këshill, e jo si delegatë ose përfaqësues të një interesi të veçantë grupor.

**Mbledhjet dhe kryesimi**

**Neni 6**

- 1) Mbledhjet e Këshillit Drejtues i thërret dhe i kryeson kryesuesi i Këshillit Drejtues.
- 2) Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson zëvendëskryesuesi. Nëse edhe kryesuesi edhe zëvendëskryesuesi nuk kanë mundësi të thërresin apo marrin pjesë në mbledhje, mbledhjen e Këshillit Drejtues e thërret dhe e kryeson anëtari më i vjetër i Këshillit Drejtues. Veprimi në kundërshtim me këtë paragraf paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe sanksionohet konform akteve normative në fuqi.
- 3) Kryesuesi i thërret mbledhjet sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, mbledhjet e Këshillit Drejtues mbahen më së paku në çdo katër javë.
- 4) Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këto mbledhje duhet të jetë i kufizuar me një pikë kryesore. Gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhjeje të ardhshme të Këshillit. Në këto raste, anëtarët e Këshillit Drejtues që nuk janë të pranishëm duhet të ftohen posaçërisht.
- 5) Në rast të shkarkimit të kryesuesit dhe të zëvendëskryesuesit, anëtari më i vjetër i Këshillit Drejtues e organizon procedurën e zgjedhjes pa asnjë vonesë.
- 6) Mbledhjet e Këshillit Drejtues janë të hapura për publikun, pos në rastet kur Këshilli Drejtues vendos ndryshe.
- 7) Anëtarët e Këshillit Drejtues do të ftohen më së paku tri ditë para mbledhjes. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me fax, me e-mail ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurt.
- 8) Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe që të ftojë në mbledhje ekspertë ose persona të tjerë.
- 9) Kryesuesi është i obliguar të thërresë mbledhjen e Këshillit Drejtues nëse këtë e kërkojnë së paku 2/3 e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe nëse qëllimi është i arsyetuar me shkrim.
- 10) Nëse kryesuesi/zëvendëskryesuesi i Këshillit Drejtues nuk i përgjigjet kërkesës e së paku 2/3 të anëtarëve të Këshillit Drejtues për thirrjen e mbledhjes brenda afatit prej tri ditësh, mbledhjen e thërret anëtari më i vjetër i Këshillit Drejtues.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

**Pjesëmarrja dhe votimi në mbledhje**

**Neni 7**

- 1) Të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues.
- 2) Anëtarët e Këshillit Drejtues votojnë personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës.
- 3) Para se të fillojë mbledhja e Këshillit Drejtues, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Këshillit Drejtues mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i Këshillit duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin.
- 4) Rektori dhe sekretari i përgjithshëm janë anëtarë ex-officio të Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote.
- 5) Me ftesë të Këshillit Drejtues, në takimet e Këshillit Drejtues mund të marrin pjesë edhe prorektorët, por pa të drejtë vote.
- 6) Kryesuesi i Parlamentit të Studentëve mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote, kur trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me studentët. Pjesëmarrja koordinohet paraprakisht me kryesuesin e Këshillit Drejtues.

**Konflikti i interesit**

**Neni 8**

- 1) Për një anëtar të Këshillit Drejtues konsiderohet se ka konflikt interesi, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm dhe Statutit të Universitetit, nëse bie ndesh me interesin e tij publik, familjar dhe operacional.
- 2) Kryesuesi i Këshillit është i obliguar që në fillim të çdo mbledhje t'i pyes dhe paralajmëroj anëtarët e Këshillit për ekzistencën eventuale të konfliktit të interesit
- 3) Anëtari i Këshillit që është në konflikt interesi duhet ta lëshojë mbledhjen gjatë asaj kohe kur ajo çështje diskutohet.
- 4) Anëtari në konflikt interesi nuk ka të drejtë vote për çështjen përkatëse.
- 5) Në rastet kur nuk ka qartësi të plotë për ekzistencën e konfliktit të interesit, atëherë Kryesuesi i Këshillit i drejtohet me kërkesë për konstatim organit kompetent brenda universitetit apo institucionit të specializuar shtetëror. Në këtë rast, vendosja lidhur me këtë pikë të rendit të ditës shtyhet deri në konstatimin përfundimtar të konfliktit të interesit nga ndonjëri prej organeve të lartcekura.

**Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës**

**Neni 9**

- 1) Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen.
- 2) Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Këshillit Drejtues kujdeset kryesuesi në bashkëpunim me zëvendëskryesuesin, të cilit i ndihmojnë sekretari i përgjithshëm dhe rektori.
- 3) Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton se a ka kuorum, e propozon rendin e ditës, e hap diskutimin rreth rendit të ditës, e konstaton miratimin e rendit të ditës.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

- 4) Kryesuesi ia jep fjalën diskutuesit, e konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, e konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, e konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerr veprime të tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes sipas kësaj rregulloreje.
- 5) Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar propozimin.
- 6) Materialet ose kërkesat, të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes, mund të miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote.

**Ecuria e mbledhjes**

**Neni 10**

- 1) Pas miratimit të rendit të ditës kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.
- 2) Raportin dhe arsyetimin rreth secilës pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.
- 3) Të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit Drejtues mund të marrin pjesë në diskutim dhe t’i paraqesin mendimet, propozimet lidhur me çështjet, të cilat do të vendosen në mbledhje.
- 4) Kryesuesi e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjet e Këshillit askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
- 5) Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e Rregullores së punës, për veprimet dhe sjelljen e anëtarëve sipas rendit.
- 6) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t’i përmbahen temës.
- 7) Kryesuesi ka të drejtë ta ndërpresë mbledhjen përkohësisht, më së shumti 30 minuta. Me pajtimin e Këshillit Drejtues, kjo pikë mund të vazhdohet.
- 8) Kryesuesi ka të drejtë ta ndërpresë mbledhjen, nëse ai konstaton se nuk ka kushte normale për mbajtjen e mbledhjes.

**Shtyrja e shqyrtimit për mbledhjen e radhës**

**Neni 11**

Këshilli Drejtues, në bazë të propozimit të kryesuesit apo të ndonjë anëtari të Këshillit Drejtues, mund të vendosë që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

**Kërkesat dhe ankesat**

**Neni 12**

- 1) Çdo anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtë të paraqet kërkesë-ankesë për temën e caktuar.
- 2) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa-ankesa të paraqet me shkrim.





## UNIVERSITETI - UNIVERSITY “ISA BOLETINI” MITROVICË

### Kourumi dhe votimi

#### Neni 13

- 1) Për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues nevojitet kuorumi prej 4 (katër) anëtarëve. Vendimet e Këshillit Drejtues janë të plotfuqishme vetëm nëse kuorumi vërtetohet në kohën e votimit.
- 2) Para se të votohet, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
- 3) Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, Këshilli Drejtues merr vendim ose konkluzion sipas pikës së rendit të ditës.
- 4) Këshilli Drejtues i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryesuesit është vendimtare.
- 5) Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose për propozimet nga organet e Universitetit, e pastaj për propozimet e tjera.
- 6) Votimi bëhet i hapur, me ngritje dore ose me vota të fshehta. Për mënyrën e votimit Këshilli Drejtues vendos në mbledhjen përkatëse, nëse me Statutin e Universitetit nuk është paraparë ndryshe.
- 7) Anëtarët e Këshillit janë të obliguar të votojnë. Votimi bëhet: “për”, “kundër” dhe “abstenim”.

### Procedura e votimit të fshehtë

#### Neni 14

- 1) Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i formuar nga Këshilli, në përbërje prej tre anëtarëve. Së paku një anëtar i këtij komisioni duhet të jetë nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Senati apo nga radhët e anëtarëve të emëruar nga MASHT-i.
- 2) Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi konstaton se propozimi i vendimit ose konkluzioni është miratuar ose është refuzuar.

### Shumica e kualifikuar e votave dhe votimi i fshehtë

#### Neni 15

- 1) Për vendimet e mëposhtme të Këshillit Drejtues nevojitet shumica e kualifikuar e 2/3 të votave të anëtarëve:
  - a) Për shkarkimin e rektorit;
  - b) Për planin vjetor financiar.
- 2) Votimi me vota të fshehta bëhet për:
  - a) Zgjedhjen dhe shkarkimin e rektorit;
  - b) Zgjedhjen dhe shkarkimin e prorektorëve;
  - c) Inicimin për shkarkimin e dekanëve dhe të prodekanëve;
  - d) Çështjet që kanë ndikim në çështjet private të ndonjërit prej anëtarëve të Këshillit Drejtues;
  - e) Çështjet ku kryesuesi apo shumica e anëtarëve të pranishëm kërkojnë votim të fshehtë.
- 3) Numërimi i votave për këto çështje bëhet në praninë e anëtarëve.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

**Zgjedhja e rektorit**  
**Neni 16**

- 1) Rektorin e zgjedh Këshilli Drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional, të cilin e formon Senati. Komisioni profesional ka për detyrë që të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.
- 2) Këshilli Drejtues me arsyetim ligjor konkret dhe objektiv ka të drejtë që me vendim me shkrim të refuzojë listën e tërësishme të kandidatëve apo ndonjë kandidat të propozuar nga komisioni profesional.
- 3) Rektori zgjidhet me votim të fshehtë nëpërmjet fletëvotimeve. Fletëvotimi do t'i përmbajë të gjithë kandidatët e përcaktuar në listën e komisionit profesional. Secili anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtë ta rumbullakojë një kandidat në fletëvotim. Fletëvotimet që kanë të rumbullakuar më shumë se një kandidat do të konsiderohen të pavlefshme. Numri total i votave numërohet për secilin kandidat. Kandidati, i cili e arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote ( së paku katër vota), zgjidhet rektor.
- 4) Nëse asnjë kandidat nuk e arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve (së paku katër vota) në radhën e parë, dy kandidatët me numër më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë.
- 5) Nëse asnjëri prej dy kandidatëve nuk arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve (së paku katër vota), në tri radhë të njëpasnjëshme të votimit, procedura e zgjedhjes do të përsëritet nga fillimi me shpalljen e konkursit për pozitën e rektorit.

**Zgjedhja e prorektorëve**  
**Neni 17**

- 1) Rektori e propozon listën e emrave për prorektorë nga radhët e profesorëve të Universitetit. Propozimi me shkrim duhet t'u dorëzohet anëtarëve të Këshillit Drejtues më së voni kur dërgohet ftesa për mbledhjen për zgjedhje.
- 2) Propozimet duhet të jenë të arsyetuara mirë dhe të përfshijnë edhe jetëshkrimin e kandidatit.
- 3) Prorektorët zgjidhen nga Këshilli Drejtues me shumicën absolute të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- 4) Nëse kandidati i propozuar nuk zgjidhet, atëherë rektori ka të drejtë ta propozojë kandidatin e ri, sipas procedurës së paraparë.

**Mbajtja e rendit dhe masat**  
**Neni 18**

- 1) Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi.
- 2) Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhjen e Këshillit Drejtues janë të obliguar që t'i përmbahen kësaj rregulloreje.
- 3) Për shkeljen e rendit në mbledhje mund të shqiptohen këto masa:
  - a) Vërejtje,



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

- b) Marrja e fjalës, dhe
- c) Largim nga mbledhja.

**Shqiptimi i masave**

**Neni 19**

- 1) Vërejtje me gojë mund t’i shqiptohet të pranishmit, nëse me sjelljen dhe diskutimin e tij e çrregullon dhe e pengon punën normale të mbledhjes.
- 2) Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit të Këshillit Drejtues, i cili me sjelljet dhe deklaratat e tij e çrregullon punën normale të Këshillit Drejtues, për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtje.
- 3) Vërejtjen dhe marrjen e fjalës ia shqipton kryesuesi.
- 4) Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit, nëse edhe pas marrjes së fjalës e pengon mbarëvajtjen e mbledhjes.
- 5) Largimin nga mbledhja e shqipton Këshilli Drejtues me shumicë votash. Pjesëmarrësi, të cilit i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë ta lëshojë mbledhjen. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

**Procesverbali i mbledhjeve**

**Neni 20**

- 1) Në çdo mbledhje të Këshillit Drejtues mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi dhe nga procesmbajtësi.
- 2) Procesverbali duhet t’i përmbajë këto elemente:
  - a) Vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes;
  - b) Rendin e ditës;
  - c) Listën e pjesëmarrësve dhe të atyre që mungojnë;
  - d) Të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse, dhe
  - e) Shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.Dokumentet shtesë duhet t’i bashkëngjiten procesverbalit si aneks.
- 3) Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së Këshillit Drejtues dhe si ekstrakt duhet t’u dërgohet anëtarëve të Këshillit Drejtues me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të Këshillit Drejtues.
- 4) Procesverbali miratohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Drejtues.
- 5) Procesverbali ruhet në arkiv të Universitetit me materialet shqyrtuese, sipas pikëve të rendit të ditës, si dokumente afatgjate.

**Formimi dhe puna e komisioneve**

**Neni 21**

- 1) Komisionet janë organe ndihmëse të Këshillit Drejtues.
- 2) Komisionet formohen nga Këshilli Drejtues në pajtim me Statutin e Universitetit dhe e ndihmojnë Këshillin Drejtues lidhur me çështjet e veçanta të punës së tij.





**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

**Aktet juridike**  
**Neni 22**

- 1) Këshilli Drejtues nxjerr:
  - Rregullore;
  - Vendime;
  - Konkluzione;
  - Rekomandime.
- 2) Këshilli Drejtues jep interpretim autentik të akteve që miraton.
- 3) Procesmbajtësi është i obliguar që t'i përgatisë vendimet dhe rekomandimet nga mbledhja e Këshillit Drejtues, ndërsa rregulloret i përgatit komisioni përkatës.

**Zbatimi i rregullores**  
**Neni 23**

Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejnë për të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues dhe personave të tretë të ftuar ose të angazhuar në procedurat e Këshillit Drejtues.

**Zbatimi i Statutit dhe Ligjit për Arsimin e Lartë**  
**Neni 24**

- (1) Për të gjitha çështjet, të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë.
- (2) Çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e punës së Këshillit dhe që nuk janë të rregulluara me ligj, statut dhe këtë rregullore, mund të rregullohen më vendim të veçantë të Këshillit.

**Zbatimi dhe interpretimi i rregullores**  
**Neni 25**

- 1) Për zbatimin e drejtë të kësaj rregulloreje kujdeset kryesuesi i Këshillit Drejtues.
- 2) Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e jep Këshilli Drejtues.

**Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores**  
**Neni 26**

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje mund të bëhet sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes.

**Shfuqizimi i rregullores paraprake**  
**Neni 27**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen dispozitat e Rregullores mbi punën e Këshillit Drejtues nr. 527, të datës 28.03.2019.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

---

**Hyrja në fuqi  
Neni 27**

Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

  
Prof. dr. Ali Topalli